



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.60/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në rrugë publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,400.00 (dymijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 05.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 04.06.2017 në sheshin qendror të qytetit të Pejës në Bulevardin Nëna Tereza në afërsi të ProCredit Bank monitoruesit e tyre kanë hasur në postere të kandidatëve për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA të ngjitur në drunjë të qytetit në hapsira publike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara dhe CD lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 06.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA thekson se shkeljet nuk janë të qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore, prandal lidhur me këtë koalicioni PDK-AAK-NISMA ka evituar shkeljet dhe ka ndermar te gjitha veprimet duke i larguar te gjitha ato nga vendi ku kane qene te vendosura

Si dëshmi ka bashkangjitur fotografit me të cilat shihet se janë larguar posterat nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA janë vendosur në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, janë vendosur në rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet koalicioni PDK-AAK-NISMA në përgjigjen në ankes të datës 06.06.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat e kandidatit për deputet nga ky koalicion janë vendosur në rrugë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se Koalicionit në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.60/2017 më datën 06.06.2017.



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*